



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1050/2021

Paneli Zgjedhës për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, Xhevdet Uka nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë dega në komunën e Skenderajt, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1050/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për antar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt, Xhevdet Uka, nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Skenderajt, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 04.11.2021, nga Xhevdet Uka, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt nga subjekti politik LVV, me seli në Prishtinë dega në komunën e Skenderajt, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2114b/03R ka pasur manipulim të votave dhe se votat e familjare të tij i mungojnë, i njëjti ka paraqitur apel në PZAP, po formularin e ankesës nuk e ka nënshkruar dhe ska ofruar asnjë dëshmi lidhur me këtë apel.

Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara lidhur me mungesën e votave të tij dhe

pasqyrimin jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin në rastin konkret, paneli nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje apo mungesë të votave të parashtruesit të apelit, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Xhevdet Uka kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Skenderajt nga subjekti politik LVV, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë regjistrimit të votave për kandidatin dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Xhevdet Uka nga subjekti politik LVV, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1050/2021 më datën 07.11.2021



Kryesuese e Panelit
Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.